Newsletter
E DREJTA PËR INFORMIM
TETOR 2026
VITI VII

Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit

Komisioneri Dervishi: “Liria fillon me mundësinë për të ditur”

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në cilësinë e Presidentit të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), drejtoi sesionet publike të edicionit të 17-të të kësaj organizate, që u zhvillua në datat 28–30 shtator 2026, në kryeqytetin e Sierra Leones, Freetown. Aktiviteti me tematikë qendrore “*Mbrojta e integritetit të informacionit*” mblodhi së bashku përfaqësues nga 41 vende për të diskutuar mbi të drejtën për informim, transparencën dhe besueshmërinë e informacionit në epokën digjitale.

E organizuar nga autoriteti pritës i Sierra Leones, në bashkëpunim me ICIC dhe UNESCO-n (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën), ajo bashkoi për herë të parë takimin ndërkombëtar të Komisionerëve të informimit me Konferencën globale për Ditën Ndërkombëtare të Aksesit Universal në Informacion.





Në fjalën hapëse, z. Dervishi e lidhi simbolikën e Freetown-it me të drejtën e qytetarëve për të ditur dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje. “*Liria fillon me mundësinë për të ditur. Një qytetar pa qasje në informacion mund të jetë formalisht i lirë, por mbetet praktikisht jashtë vendimmarrjes*”, theksoi ai.

Komisioneri nënvizoi se teknologjitë digjitale dhe inteligjenca artificiale zgjerojnë mundësitë për informim, por e bëjnë më të vështirë dallimin e informacionit autentik nga përmbajtja e manipuluar. Ai nënvizoi se mungesa e informacionit zyrtar krijon hapësirë për spekulime dhe dezinformim.

“*Dezinformimi udhëton pa pasaportë dhe me shpejtësi globale. Prandaj, edhe përgjigjja jonë duhet të kapërcejë kufijtë institucionalë dhe kombëtarë*”, u shpreh Dervishi, duke kërkuar forcimin e bashkëpunimit mes autoriteteve rregullatore në këtë drejtim.

vijon në fq. 2

vijon nga fq. 1

Zëvendëspresidenti i Sierra Leones, z. Mohamed Juldeh Jalloh, theksoi se aksesi në informacion është thelbësor për forcimin e demokracisë, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, transparencën dhe rritjen e besimit te institucionet. Ai shprehu nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar dhe për sisteme më të forta të qeverisjes së informacionit, veçanërisht përballë sfidave të epokës digjitale dhe inteligjencës artificiale.

Ministri i Informimit, z. Chernor Bah, e cilësoi aktivitetin si një "*konferencë të lirisë*" dhe kërkoi rekomandime praktike për mbrojtjen e së drejtës së qytetarëve për të ditur dhe për të bërë zgjedhje të informuara. Komisioneri i Sierra Leones, z. Ibrahim Seaga Shaw, tha se zgjerimi i qasjes në informacion përmes platformave digjitale duhet të shoqërohet me garantimin e saktësisë dhe besueshmërisë së tij.



Ndihmësdrejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s për Komunikimin dhe Informacionin, znj. Mariya Gabriel, nënvizoi lidhjen mes qasjes në informacion dhe integritetit të tij, si dhe nevojën për ta bërë këtë të drejtë të zbatueshme në praktikë.

Gjatë sesioneve u diskutua për publikimin proaktiv, dhënien në kohë të informacionit zyrtar, qeverisjen e hapur, edukimin mediatik dhe balancën mes transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Një sesion iu kushtua testimit të zbatimit të së drejtës për informim përmes kërkesave të njëjta drejtuar autoriteteve publike në 120 vende. Programi trajtoi edhe aksesin e barabartë për gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi ndryshe, si dhe përdorimin e informacionit për çështjet mjedisore dhe reagimin ndaj krizave.



vijon në fq. 3

vijon nga fq. 2

Në panelin "*Nga transparenca te publikimi proaktiv: drejt një standardi të ri ndërkombëtar*", Zyra e Komisionerit u përfaqësua me znj. Emerlinda Pema, Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës. Në fjalën e saj, ajo nënvizoi se publikimi proaktiv kërkon ndryshim të kulturës institucionale, pasi autoritetet publike duhet të parashikojnë nevojat për informacion dhe ta publikojnë atë pa pritur kërkesa nga qytetarët, gazetarët apo shoqëria civile.



Në mbyllje të sesioneve publike, Komisioneri Dervishi theksoi se informacioni duhet të jetë i saktë, i kuptueshëm dhe të jepet në kohën kur qytetarëve u nevojitet. "*Shpejtësia pa saktësi krijon konfuzion, ndërsa saktësia pa dhënien në kohë humbet vlerën e saj publike*", u shpreh ai.

Duke vlerësuar miratimin e Deklaratës së Përbashkët të Freetown-it, Presidenti i ICIC kërkoi që angazhimet e saj të zbatohen përmes veprimeve konkrete, forcimit të standardeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, për t'u garantuar qytetarëve informacion të aksesueshëm dhe të besueshëm.

Programi përfshiu edhe ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit për rinovimin e bashkëpunimit ICIC–UNESCO. Z. Dervishi vlerësoi rëndësinë e këtij partneriteti, i cili bashkon ekspertizën globale të UNESCO-s me përvojën e autoriteteve që garantojnë zbatimin e së drejtës për informim.





28 Shtator 2026 – Transparenca i jep zë qytetarit dhe përgjegjësi pushtetit

28 Shtatori-Dita Ndërkombëtare e së Drejtës për Informim na kujton se një shoqëri demokratike ndërtohet mbi institucione transparente dhe qytetarë të informuar.

Kjo datë u shpall nga UNESCO në vitin 2015 si Dita Ndërkombëtare për Aksesin Universal në Informacion, duke njohur rëndësinë themelore që ka ushtrimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Në vitin 2019, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara e njohu zyrtarisht 28 Shtatorin si Ditë Ndërkombëtare.

Qasja në informacionin publik u jep qytetarëve mundësinë të kuptojnë se si merren vendimet, si përdoren burimet publike dhe si ushtrohet pushteti, duke krijuar njëkohësisht më shumë përgjegjësi dhe llogaridhënie për institucionet. Në kuadër të kësaj dite, Zyra e Komisionerit këtë vit ndërmori një nismë ndërgjegjësuese, përmes shpërndarjes dhe afishimit të posterave informues pranë autoriteteve publike.



Me mesazhin "*Ti ke të drejtë të informohesh. Ne kemi detyrim të përgjigjemi*", materialet synojnë të nxisin forcimin e transparencës dhe komunikimin e hapur nga autoritetet publike, si dhe t'u ofrojnë qytetarëve informacion praktik për ushtrimin e kësaj të drejte.

Përmes skanimit të kodeve të vendosura në materiale, qytetarët mund të shkarkojnë drejtpërdrejt modelin e formularit të kërkesës për informim, ose të plotësojnë formularin e ankesës pranë Zyrës së Komisionerit. Krahas afishimit fizik, materialet iu përcollën shumë autoriteteve publike edhe në format elektronik, të cilat u publikuan në faqet e tyre zyrtare në internet, si një mënyrë më e shpejtë dhe efektive për të bashkëvepruar me publikun.

Në këtë mënyrë, informacioni bëhet i aksesueshëm jo vetëm në mjediset e autoriteteve publike, por edhe për qytetarët që përdorin shërbimet dhe platformat e tyre online.

Kjo nismë përcjell mesazhin se çdo institucion publik ka një rol thelbësor në ndërtimin e një administrate më të hapur, më të aksesueshme dhe më pranë qytetarëve. Transparenca nuk duhet parë vetëm si një detyrim ligjor, por si një mënyrë funksionimi që forcon marrëdhënien mes institucioneve dhe publikut.

E drejta për informim nuk është privilegj, por një e drejtë themelore dhe një shtyllë e demokracisë, integritetit institucional dhe besimit të publikut.

Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë e lobimit, Komisioneri Dervishi: Publiku duhet të dijë kush ndikon në vendimmarrje!

Zyra e Komisionerit organizoi takimin "*Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë e lobimit*", me fokus kuadrin e ri ligjor për lobimin në Shqipëri dhe paketën e projektakteve nënligjore që do të mundësojnë zbatimin e tij në praktikë.

Takimi u përshëndet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, Ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, znj. Giulia Re dhe Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, znj. Siri Walt. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike, partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile.



Në fjalën e tij, Komisioneri Dervishi theksoi se kuadri i ri për lobimin synon të rrisë transparencën mbi mënyrën se si interesa dhe aktorë të ndryshëm ndërveprojnë me vendimmarrjen publike. "Kur përmendet fjala lobim, shpesh krijohet përshtypja se biseda kryhet në korridor të errët, mundësisht edhe me perde të rënda e të mbyllura. Kuadri i ri ligjor, por edhe objektivi ynë, është t'i japë dritë këtij mjedisi dhe të kemi një marrëdhënie të institucionalizuar", u shpreh Komisioneri.



Z. Dervishi nënvizoi se në një sistem demokratik është e natyrshme që vendimmarrësit të dëgjojnë ekspertizën dhe interesat e grupeve të ndryshme, ndërsa problemi lind kur ndikimi mbetet i padukshëm ose kur mundësia për t'u dëgjuar perceptohet si privilegj i një numri të kufizuar aktorësh. "*Në një sistem demokratik interesat trokasin në derën e vendimmarrjes. Por, publiku duhet ta dijë kush trokiti, për kë dhe për çfarë*", theksoi ai.

Ligji nr. 12/2026 "Për lobimin" i ka ngarkuar Zyrës së Komisionerit mbikëqyrjen e kuadrit të ri dhe kompetencën për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore.

vijon në fq. 6

vijon nga fq. 5

Komisioneri vlerësoi se kjo përgjegjësi e re nuk është e shkëputur nga roli që institucioni ushtron prej vitesh si garant i së drejtës për informim, por lidhet drejtpërdrejt me transparencën, aksesin në informacion dhe llogaridhënien e institucioneve publike. "*E drejta e informimit i mundëson publikut të njohë vendimet dhe dokumentet, ndërsa transparenca e veprimtarisë së lobimit bën të dukshme rrugën e ndikimeve që u paraprin vendimeve. Të dyja i shërbejnë një pushteti publik më të hapur dhe më të përgjegjshëm*", deklaroi z. Dervishi.



Znj. Adea Pirdeni e cilësoi ndërtimin e kuadrit të ri ligjor si një proces të vështirë dhe sfidues. "*Me ligjin për lobimin kemi zgjedhur të vendosim transparencën në themel të mënyrës se si interesat ndërveprojnë me vendimmarrjen publike. Tani përgjegjësia jonë është që këtë parim ta bëjmë real në praktikë, përmes rregullave të qarta, institucioneve të përgjegjshme dhe një standardi që forcon besimin e publikut në vendimmarrje*", u shpreh ministrja Pirdeni.



Në fjalën e saj, znj. Giulia Re nënvizoi rëndësinë e transparencës dhe të rregullave të qarta në këtë fushë. "*Lobimi është një pjesë legjitime e pjesëmarrjes demokratike, por ai duhet të jetë transparent, i përgjegjshëm dhe t'u nënshtrohet rregullave të qarta. Transparenca nuk e pengon dialogun mes vendimmarrësve dhe atyre që preken nga vendimet e tyre; përkundrazi, ajo ndihmon që ky dialog të zhvillohet në mënyrë të hapur dhe të drejtë*", theksoi ambasadorja Re.

Ndërsa, znj. Siri Walt theksoi se transparenca në procesin e vendimmarrjes forcon besimin tek institucionet publike. "*Kur qytetarët mund të shohin se kush ndikon në vendimmarrjen publike dhe se si merren vendimet, besimi tek institucionet publike rritet. Transparenca ndihmon në krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë aktorët dhe zvogëlon mundësitë për ndikim të paligjshëm dhe korrupsion*", tha ambasadorja Walt.



Gjatë aktivitetit u prezantua paketa me projektaktet nënligjore, e hartuar me ekspertizën e Këshillit të Evropës dhe financimin e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Dokumentet përcaktojnë në mënyrë konkrete funksionimin dhe administrimin e Regjistrit të Lobimit, procedurat e regjistrimit, deklarimin e veprimtarisë së lobimit, identifikimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit, verifikimin dhe përditësimin e të dhënave, administrimin e dokumentacionit, si dhe standardet e sjelljes. Në takim u diskutua mbi transparencën e lobimit dhe integritetin në vendimmarrje nga perspektiva e politikave publike, standardet dhe praktikat evropiane për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor, si dhe perspektiva e shoqërisë civile mbi transparencën, pjesëmarrjen dhe integritetin në vendimmarrje.

RRUGA ABDI TOPTANI, ND. 5, KODI POSTAR 1001, TIRANË / INFO@IDP.AL / +35542237200

Rregullimi i lobimit, Zyra e Komisionerit prezanton modelin shqiptar në tryezën rajonale në Prishtinë

Zyra e Komisionerit mori pjesë në tryezën rajonale "Drejt rregullimit të lobimit: gjetjet, përvojat rajonale dhe hapat e mëtejshëm", të zhvilluar në Prishtinë. Aktiviteti u organizua nga Këshilli i Evropës, në kuadër të veprimit të përbashkët me Bashkimin Evropian, me qëllim diskutimin e gjetjeve të studimit mbi mundësinë e rregullimit të lobimit në Republikën e Kosovës dhe shkëmbimin e përvojave rajonale për rritjen e transparencës në vendimmarrje.

Në tryezë morën pjesë përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera publike, nga shoqëria civile dhe sektori i biznesit. Të ftuar në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësues të institucioneve mbikëqyrëse homologe nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.





Zyra e Komisionerit prezantoi modelin shqiptar të rregullimit të lobimit. Drejtoresha e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, znj. Rovena Sulstarova, u ndal te kuadri ligjor, përgjegjësitë institucionale dhe procedurat për zbatimin e tij. Prezantimi trajtoi çështje si njohja e lobimit si veprimtari e ligjshme, transparenca dhe përgjegjshmëria, si dhe detyrimet e ndalimet për subjektet që e ushtrojnë atë. Vëmendje, po ashtu, gjatë prezantimit iu kushtua aspekteve që kanë të bëjnë me procesin e regjistrimit, administrimin e informacionit, orientimin e subjekteve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kuadrit ligjor. Në këtë kontekst, u paraqit puna për përgatitjen dhe miratimin e akteve nënligjore, formularëve, regjistrave dhe procedurave të nevojshme për funksionimin praktik të sistemit. Duke qenë se Shqipëria ndodhet në fazat fillestare të zbatimit, u theksua rëndësia e udhëzimit të subjekteve dhe e krijimit gradual të një praktike të qëndrueshme administrative.

Shkëmbimi rajonal shërbeu për të identifikuar nevojën për udhëzime praktike mbi dallimin ndërmjet lobimit, konsultimit publik dhe advokimit, si dhe për vlerësimin e zbatimit pas krijimit të praktikave të para. Këto elemente mbështesin ndërtimin e një sistemi që e bën më transparent ndikimin në vendimmarrjen publike dhe forcon përgjegjshmërinë institucionale. Zyra e Komisionerit paraqiti gjithashtu, gjatë takimit në Bruksel, në kuadër të takimit të radhës së Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike BE–Shqipëri, punën dhe hapat e ndjekur për krijimin e ekosistemit rregullator për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit në vendin tonë.